



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 95/1 Prot.

Tiranë, më 03.02 2015

VENDIM

Nr. 14, datë 03/2 /2015

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, nenit 31/1/a të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 95 Prot., datë 26.01.2015, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/ Departamenti i Administratës Publike (DAP). Nga provat bashkëngjitur ankesës rezulton se, ankuesi në cilësinë e kërkuarit ka paraqitur pranë Autoritetit Publik/ Departamenti i Administratës Publike, shkresën datë 05.01.2015, ku ka kërkuar të informohet lidhur me rezultatin e tij dhe të dy kolegeve për konkursin e datës 16.12.2014 të organizuar nga DAP.

Nga shqyrtimi i ankesës, konstatohet se ankuesi/ _____, legjitimohet të paraqesë këtë ankesë, në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Nga provat e administruara bashkëlidhur ankesës rezulton se, Autoriteti Publik/ Departamenti i Administratës Publike i është përgjigjur pjesërisht kërkuarit lidhur me kërkesën e tij për informim. Në përgjigjen e dhënë me e-mailin e datës 09.01.2015, janë vënë në dispozicion të ankuesit _____, rezultatet e konkursit vetëm për të. Në këtë e-mail citohet se, pikët e konkurrentëve të tjerë, ndalohet të publikohen sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Nëpërmjet shkresës nr.3548/2 Prot., datë 13.01.2015, DAP ka informuar kërkuarin për ngritjen e komisionit të rivlerësimit sipas ankesës së tij për rezultatet e konkursit, ka bashkëlidhur procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim si dhe një kopje të shkresës së rezultateve të testimit dhe procesverbalit për një prej konkurrentëve (shkresa nr.3549/2Prot., datë 13.01.2015). Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri ka trajtuar ankesën bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Autoriteti publik duhet të trajtonte kërkesën në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" për të vlerësuar nëse informacioni i kërkuar i përket informacionit që bëhet publik pa kërkesë si dhe me nenin 17 të ligjit të lartpërmendur për të vlerësuar nëse informacioni mund të refuzohet në dhënien e tij tërësisht apo pjesërisht për shkak të kufizimeve që përcakton kjo dispozitë dhe më pas të jepte përgjigjen e duhur ligjore. Nga shqyrtimi i ankesës rezultoi se, ky informacion nuk i nënshtrohet kufizimeve të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe përcaktimeve të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Informacioni i kërkuar përfshihet në informacionin që bëhet publik pa kërkesë, konkretisht në nenin 7 pika 1 gërma "l" të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjin nr.152/2013 "Për nënpunësin civil" i ndryshuar si dhe VKM nr. 143 kreu IV pika 16, datë 12.03.2014. Konstatohet se informacioni është dhënë për një prej kërkuësve dhe nuk argumentohet mbi refuzimin e dhënies për konkurrentin tjetër. Në përputhje me pikën 4 të nenit 15 të ligjit të lartpërmendur mostrajtimi i kërkesës për informim (në përputhje me objektin e kërkesës) brenda afateve të përcaktuara në ligj konsiderohet refuzim. Në përputhje me shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" "Refuzimi i dhënies së informacionit në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji dënohet me 15.000 deri në 300.000 lekë".

Në përfundim, në lidhje me ankesën e [] kundër autoritetit publik/ Departamenti i Administratës Publike, Komisioneri vlerëson se, ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në pikën 5/b/ç të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit",

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 95 Prot., datë 26.01.2015 të [] kundër autoritetit publik/Departamentit të Administratës Publike.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Departamenti i Administratës Publike për të dhënë informacionin/dokumentacionin e kërkuar ankuesit brenda datës 10.02.2015.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative kompetente, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Ky vendim u dha sot në datë 02.02.2015.

